



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 060/01-10856/2018

Datë. 30.04.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2018, e mbajtur me datën 30.04.2018, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 34 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska –Milla, znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Faton Gutaj, znj. Diana Qarkaxhija, znj. Hana Zeka, znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Jeton Vorfi, z. Agon Batusha, znj. Mimoza Shala, znj. Lirika Komoni, z. Krishnik Alijaj, z. Bekim Jupa. znj. Miranada Lushaj, znj. Dafina Sylja, z. Halit Isufi, z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi, z. Shpend Komnova.

Mungon : z. Basri Komoni .

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtoret e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: I nderuar Kryetar i Komunës z. Ardian Gjini, të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Drejtor të drejtorive Komunale, te nderuar përfaqësues të OSBE-së që jeni prezent sot këtu , të nderuar përfaqësues të Mediave,.

Sot do ta kemi mbledhjen e pestë të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, dhe kemi Mbajtur edhe dy mbledhje të jashtëzakonshme, ju njoftoj se të pranishëm në këtë mbledhje janë: 34, anëtarë, meqenëse kemi koriumin po fillojmë me mbledhjen .

Kryesuesi: Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën dhe materialin e mbledhjes sipas afateve të përcaktuara ligjore andaj e hapi diskutimin a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket pikave të rendit të ditës për këtë mbledhje.

z. Bekim Jupa: Ne jemi takuar me klubin Hendbollistik Shqiponja të cilët me dt. 29.03.2018 kanë bërë kërkesë për mbështetje financiare andaj kërkoj që kjo të jetë si pikë e rendit të ditës për këtë mbledhje.

Kryesuesi: Propozoj që kjo pikë të diskutohet në të ndryshme sepse nuk i kemi mjetet e parapara për këtë kërkesë si dhe nuk duhet që të krijojmë një praktik ku do të vërshohemi me kërkesa nga klubet tjera .

z. Bekim Jupa: Ne kërkojmë që kjo pikë të hedhet në votim që të futet si pikë e rendit të ditës e tani diskutojmë se si të veprohet .

z. Muharrem Musa : Unë fillimisht kërkoj që të kemi një konsultim me shefat e grupeve sepse ne kemi biseduar për këtë kërkesë por nuk kemi marrë një qëndrim .

z. Bekim Jupa: Unë nuk po kuptoj se kujt po i pengoj ky diskutim ne po kërkojmë që të hedhet në votim dhe të futet si pik e rendi të ditës.

z. Bekim Ermeni: Kjo kërkesë mundet të diskutohet edhe në të ndryshme mirëpo unë nuk po kuptoj se kjo kërkesë çfarë vlere ka a është mbi 15.000€ sepse Kuvendi merr vendimi vetëm për kërkesat mbi këtë shumë, mirëpo ne në këtë periudhë e kemi një ftes publike nga DKRS për aplikim për subvencione nga Klubet sportive dhe OJQ-ve në Komunën e Gjakovës, andaj edhe ku klub duhet të hartoi një projekt dhe të aplikoj për këto subvencione dhe nëse kërkesa është mbi këtë shumë atëherë DKRS-ja të dërgoj këtë kërkesë në mbledhjen e radhës së Kuvendit sepse nuk është në rregull që kjo kërkesë të vije direkt këtu në Kuvend kur e kemi njoftimin publik për aplikim në DKRS, sepse kjo është një ndërhyrje në proces dhe ky klub po trajtohet si i veçante, sa i përket kësaj kërkesë gjithsesi se mundemi ta diskutojmë në të ndryshëm dhe të marrim një qëndrim.

z. Zef Komani: Kërkesa e z. Bekimit nuk është që të miratohet kjo kërkesë por të futet si pike në rend dite dhe të diskutohet në këtë mbledhje, sepse ky është një klub që merr pjesë në garat ndërkombëtare dhe ka nevojë për mbështetje institucionale andaj kërkoj që kjo pikë të futet si pik e rendit të ditës dhe kërkoj nga ju kryesues , që të mbahet një minutë heshtje për të ndjerin Art Kurti, i cili ka qenë punëtori i kabinetit .

Kryesuesi: Para se të vazhdojmë me mbledhje kërkoj që të mbahet një minuta heshtje për kolegun dhe bashkëpunëtorin tonë të ndjerë z. Art Kurti i cili pra pak dite ka ndërruar jetë. Kuvendi me një minutë heshtje e ka nderuar të ndjerin z. Art Kurti.

Kryesuesi: E qes në Votim miratimin e rendit të ditës sipas ftesës së bërë që në piken e 7 të diskutohet kërkesa e KH Shqiponja për mbështetje financiare, kush është: për, kundër abstenim. Nga anëtarët e Kuvendmi të Komunës **unanimisht** u votua për rendin e ditës.

Pas votimit u miratua Ky :

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 30.03.2018.
2. Nisma për Bashkëpunimin Ndër Komunal me Komunën Fort Dodge, Iowa USA .
3. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror.
4. Informate mbi menaxhimin e mbeturinave.
5. Informate mbi ndriçimin publik.
6. Informata e parë financiare Janar Mars 2018 .
- 7.Shqyrtimi i kërkesës së KH Shqiponja për mbështetje financiare
8. Të Ndryshme .

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 30.03.2018

Kryesuesi: Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 30.03.2018, a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverballi .

z. Zef Komani: Kërkoj që të plotësohet fjalimi im ku thotë: Kërkoj që premtimi nga Kryetari të mbahet dhe të ftohen policia departamenti i shëndetit primar, nga kujdesi i psikiatrisë dhe të fillohet me punë për shpërndarjen e tyre, nuk është cekur se çka me shpërnda andaj kërkoj që të përmirësohet .

znj. Miranda Lushaj: Kërkoj që materiali për mbledhje të më dërgohet në kopje elektronike sepse me postë po më vije dy ditë pas mbledhjes .

Kryesuesi: E qes në Votim miratimin e Procesverbalit me vërejtje e paraqitura. **Kush është: Për, kundër, Abstenim.**

Nga Anëtarët e Kuvendit të Komunës Unanimisht u miratuan procesverballi nga mbledhja e kaluar me përmirësimet e kërkuara.

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Nisma për Bashkëpunimin Ndër Komunal me Komunën Fort Dodge, Iowa USA .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Nisma për Bashkëpunimin Ndër Komunal me Komunën Fort Dodge, Iowa USA , ku procedurat e parapara fillimisht kërkojnë që të miratohet nisma e Kryetarit të Komunës për të hyrë në Bashkëpunim ndër Komunal dhe pastaj vazhdojnë procedurat tjera të nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i Komunës edhe Përfaqësuesi i komunës përkatëse në këtë rast me Komunën Fort Dodge, Iowa USA, andaj e ftoj kryetarin e Komunës z. Ardian Gjini që ta merr fjalën .

Kryetari: Kjo është një nismë e më hareshme dhe është një nismë e mirë por nga MAPL kemi pranuar një shkresë që ka kërkuar të ndjeke disa procedura që nuk janë ndjekur më herët që kjo nismë duhet të miratohet në Kuvend pas nënshkrimit, pra kjo është vetëm ndjekej e procedurave të parapara ligjore .

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime E qes në votim miratimin e Nisma për Bashkëpunimin Ndër Komunal me Komunën Fort Dodge, Iowa USA , **Kush është: Për, Kundër, Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro**, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Gjakovës për të hyrë në bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar të Komunës së Gjakovës me Komunën Fort Dodge, Iowa USA .
2. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që të ndjek procedurat e nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin e propozim Marrëveshjes për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar me Komunën Fort Dodge, Iowa USA .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

3. Pika e tretë e rendit të ditës: Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror, edhe kjo pikë është e paraparë në Planin e Punës së Kuvendit dhe e ftoj Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Shkumbim Kastrati që të merr fjalën .

z. Shkumbim Kastrati: Komuna e Gjakovës në janar të vitit 2018 ka kontraktuar dy kompani për mirëmbajtje të rrugëve në zonën urbane dhe në zonën rurale, me dt.20.01.2018, kemi filluar me lëshimin e urdhërave dhe intervenim, ndërsa me intervenimet e fundit janë kryer me dt.22.03.2018 dhe 23.03.2018. Mirëmbajtja e rrugëve në komunën e Gjakovës kryesisht ka qenë e mirë edhe pse kemi pasur probleme në fillimin të sezonit nga reshjet e bores sidomos në zonat kodrinore dhe malore ku në bazë të kontratës kanë qenë 300 km rrugë për mirëmbajtje, andaj është e pamundur që të veprohet paralelisht në të gjitha këto segmente, mirëpo me angazhimin e madh kemi arritur që me disa vonesa të vogla të intervenojmë në të gjitha rastet, andaj mund të themi që situata ka qenë e kënaqshme. Në të reshurat e muajit janar vlen të theksohet që kemi pasur përkrahjen e Ministrisë së Infrastrukturës sidomos në rajonin e Dushkajës ku kemi teren kodrinor - malor. Shpenzimet e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve në gjithë sezonin kanë qenë rreth 60.000€.

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

znj. Dafina Sylja: Unë kam një brengë lidhur me rrugët e qytetit ku kohëve të fundit po vërehen dëmtime të shumta ku janë shkaktuar gropa të shumta të cilat ju shkaktojnë shumë dëme materiale vozitësve dhe provokojnë shkaktimin e aksidenteve, dhe rrugët që kanë nevojë urgjente për intervenim janë rruga Kol Lleshi, Hysni Dobruan, Shefki Shasivari, Uashingtoni andaj kërkojmë sqarime se a ka ndonjë plan për rregullimin e këtyre rrugëve .

Kryetari: Arsyeja e vetme pse nuk janë rregulluar këto rrugë është se është vonuar procesi i tenderimit sepse kemi pasur ankesa dhe kjo është brengë edhe e jona mirëpo këto janë procedura që nuk kemi mundësi ti ndryshojnë .

znj. Albina Sadrija : Kërkojmë që qytetarët të jenë të informuar se cilat rrugë janë në mirëmbajtje nga kompani e caktuar në sezonin dimëror për pastrimin nga bora sepse po shkaktohen kofuzitet dhe pakënaqësi nga qytetarët vetëm për shkak të mos informimit .

z. Shkumbim Kastrati: Rrugët që janë në mirëmbajtje dhe kontratat janë në faqen Zyrtare të Komunës dhe mundeni me i shikua kur të doni por ka raste kur janë disa rrugica që janë private dhe nuk janë të regjistruar dhe në nuk kemi mundësi ti mirëmbajmë .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

4. Pika e katërt e rendit të ditës: Informate mbi menaxhimin e mbeturinave

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Informate mbi menaxhimin e mbeturinave edhe kjo pikë është e paraparë në Planin e Punës së Kuvendit dhe e ftoj Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Shkumbim Kastrati që të merr fjalën .

z. Shkumbim Kastrati: Në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar gjatë për këtë pikë dhe pajtohemi me vërejtjet e anëtarëve të KPF-së se ka dokumente dhe informata të mira por gjendja në teren nuk është e mirë.

Në qeverisjen e kaluar ka ekzistuar një task forcë për shqiptimin e dënimeve për hedhësit e mbeturinave e përbërë prej 20 personave dhe tani jemi në procedura të formimit të një trupe të tillë e përberë nga 4 drejtori ku numri i zyrtarëve do të jetë i madh .

Menaxhimi i mbeturinave është kompetencë e komunave sipas ligjit për menaxhimin e mbeturinave dhe ne shumicën e komunave ekzistojnë ndërmarrjet publike qe merren me menaxhimin e mbeturinave dhe të ne ekziston KRM- Çabrati, tek ne në Drejtorinë e shërbimeve publike kemi planifikuar mjetet dhe jemi ne procedurë të themelimit të sektorit për menaxhimin e mbeturinave, dhe është punësuar një zyrtar, mirëpo ligji e parasheh edhe arkëtimin e mjeteve përmes drejtorisë se financave gjë qe është e pamundur për momentin, sepse kërkohet një shumë e madhe mjeteve, andaj ne marrëveshjen me Ministrinë e Financave dhe me kërkesën për mirëkuptim edhe nga anëtarët e kaluar të kuvendit për mos atakimin e KRM- Çabratit, sepse nëse inkasimi i mjeteve bëhet përmes Drejtorisë se Financave atëherë edhe mirëmbajtja dhe menaxhimi i mbeturinave duhet te kaloj përmes tenderit të hapur publik dhe atëherë rrezikohen 120 vende të punës në KRM- Çabrati dhe kjo është arsyeja e kësaj gjendje edhe pse unë personalisht nuk jam i kënaqur me menaxhimin e mbeturinave. Në të kaluarën ka qenë një taks-force për kontrollimin dhe gjobitjen, mirëpo i ka skaduar mandati e tani është formuar një komision prej katër Drejtorive dhe një ndihmës e madhe është instalimi i 40 kamerave në qytet përmes te cilave janë identifikuar shumë shkelës ku kryesisht janë kompani private të cilat punojnë gjatë ditës dhe ne mbrëmje hedhin mbeturinat ne mënyrë ilegale .

Sa i përket mbeturinave i kemi disa filmime ku shihet se si hidhen mbeturinat nga disa operator privat dhe qytetar që i hedhin mbeturinat në mënyra të pa përgjegjshme dhe të gjithë këta që janë evidentuar do të sanksionohen . Ne përgjithësi mund te themi se sektori ne mirëmbajtjen e mbeturinave është e kënaqshme mbetet vetëm nga ne qe te ndërmarrim hapa konkret qe te zgjedhim këtë çështje. Po ashtu kemi edhe një përkrahje prej GIZ-it – Gjerman te mërkurën kemi bë pranim- dorëzimin e rreth 200 kontejnerëve të cilët do te shpërndahen në institucione publike. Problem kyç komuna e Gjakovës e ka qendrën e mbetjeve e cila është ne rrugën Ibra ku duhet te ndërmerren masa emergjente, kemi pas edhe disa kontrolla vitin e kaluar nga inspektorati i mjedisit nga z. Afrim Ademi ndërsa tash e këtë vit e kemi kontrollen e fundit nga sektori i menaxhimit te mbeturinave thjesht ne je4mi to obliguar qe te ndërmarrim hapa konkret për zgjidhjen e këtij problemi i cili është problem qe tejkalon normativat si ato sanitare etj. Pika tjetër qe dua te cekim është qendra e mbetjeve ne Vugove, ku kemi një kontratë me agjencionin pyjor të Kosovës e cila është nënshkruar para dy vite e gjysmë e cila kontratë është 5 vjetarë, ku ne atë qendër ne Qeverisjen e kaluar kanë filluar punimet mirëpo është dashur me stopu për shkak te natyrave te ndryshme, pra duhet qe këtë qendër të Vugovës ta funksionalizojmë, vetëm qe na mbetet qe te konsultohem dhe ta analizojmë mirë me Agjencionin Pyjor të Kosovës.

z. Kreshnik Alijaj: Ne si Lëvizje Vetëvendosje kemi një kërkesë nga banorët aty ku ndodhet autoparku, parkingu i automjeteve të Çabratit qe të dislokohet për shkak të kundërmimit të tyre pra është kërkesë imediate përndryshe rrezikohet edhe shëndeti i qytetareve.

z. Muharrem Musa: U desha te flas për mbeturinat ne zonat rurale në këtë rast për Dushkajën, te cilat Qabrati i menaxhon dhe grumbullon, ka qenë një mundësi e mirë në të kaluarën me kushtëzimin e pajisjes me dokumentacione dhe shërbime qe te hyn edhe pagesa e Qabratit për qytetarët, kjo është një e mirë edhe e qytetarit që të kemi një ambient më të pastër andaj kërkohet nga ne të gjithë që të flasim me qytetarët dhe të ruajmë ambientin mos ti hedhim mbeturinat vend e pa vend.

znj. Hana Zeka: Ne mbledhjen e KPF-së kam bërë një kërkesë për te gjitha informatat sa i përket menaxhimit te mbeturinave, dhe gjithashtu dua te cekim se te gjitha këto punime projekte apo plane te cilat u prezantuan janë punuar ne qeverisjen tonë pra ne qeverisjen e kaluar dhe kërkoj që në muajt e ardhshëm të na prezantohet se çfarë ka ndodh me ato projekte qe ne i kemi punuar .

Kërkojmë nga DUMM , Drejtoria për punë Inspektues si dhe nga Drejtoria për Punë shërbime Publike që në një mbledhje të radhës të na informojë se si është gjendje në implementimin e këtyre planeve dhe projekteve të hartuara .

z. Jusuf Osmani : Unë dua ta paraqes një shqetësim për rrugën Fitim Domi që është njëra nga rrugët më të ndotura dhe më infrastruktura më të dobët në Komunën e Gjakovës e cila qe katër vite është në vëmendjen e kronikave të ndryshme televizive dhe në këtë rrugë para 4 viteve është mbajtur konferencë nga ish kryetarja dhe kanë qenë prezent të gjitha mediat dhe ende nuk është bërë asgjë andaj kërkoj që të mirën masat dhe të bëhet ndalimi i hedheje së Mbeturinave .

z. Edmond Dushi: Unë mendoj se menaxhimi i mbeturinave është duke u bërë në mënyrë të duhur por kemi edhe qytetarë të pa ndërgjegjshëm dhe kemi shumë raste kur i shohim se edhe në shportat e destinuara për letër hedhin mbeturina të tjera si dhe kemi shporta të dëmtuara shumë andaj mendoj se duhet të gjendet një zgjidhje për këtë çështje. Grumbullimi i mbeturinave është duke u kryer me rregull. Shqetësimi imë është tregu që është i vendosur tek stacioni i grumbullimit të mbeturinave dhe kërkoj që të largohen nga aty.

z. Agon Batusha: Kjo është një pikë që i prek të gjithë qytetarët dhe është shumë e ndjeshme dhe jemi përgjegjës vet ne qytetarët për këtë gjendje. Edhe në mandatin e kaluar e kemi përkrahur të gjithë çabratin për arsye se është pronë e komunës, mirëpo ligji nuk e lejon subvencionimin e kompanive të veta nga Komuna dhe është e nevojshme që të futet në konkurrencë me kompanitë tjera që është punë me rrezik sepse kompanitë tjera munden ta mundin çabratin dhe metën 120 punëtor pa punë , problemi qëndron se disa shtëpi e paguajna vetëm një kontejner dhe kjo i shkakton dëme kopanis dhe propozoj që kur ti dërgohet faktura e tatimit në pronë ti dërgohet edhe fatura e çabratit. Ne si VV kërkojmë që të përkrahet çabrati dhe të gjobiten të gjithë ata që e dëmtojnë ambientin .

z. Sadik Hoti: Në fshatin Rugovë çabrati e bënë grumbullimin e mbeturinave dhe gjendja ka qenë jo e mirë sepse ka pasur një kamion të vjetër gjatë transportit mbeturinat i ka shpërnda në vend se ti grumbulloj, mirëpo kohëve të fundit gjendja është më e mirë, por kemi një brengë rreth ndarjes së mbeturinave siç janë mbeturinat inerte që nuk ka një vend të caktuar ku me hedh por hedhen në vende të ndryshme, inkasimi është i mirë dhe nuk është gjendja e keqe. Kërkojmë që të kemi kujdes tek tregu që të përcillet gjendja se ku hedhen ato mbeturina.

Kryetari: Lidhur me këtë temë kemi çka të flasim të gjithë mirëpo nëse nuk angazhohemi të gjithë, gjendja prapë ka me qenë e njëjtë. Gjatë këtyre katër viteve qëllimi im ka me qenë ndërtimi i një sistemi funksional, dhe për këtë i ke i tri probleme i pari është struktural, sepse kemi një kompani Publike dhe dy kompani private ilegale pra nuk kemi një struktural fikse që të dihet se çka po ndodh, problemi i dytë është funksional që lidhet me komunën siç është çështja e kontejnerëve a janë të vendosur kontejnerët a kanë qasje qytetarët në ta, ku kemi kontejnerë kolektive kemi shumë probleme dhe duhet të ndërrohet sistemi i kontejnerëve sepse me vite ka qenë gabim, e treta është problemi kultural ku unë kam qenë prezent ku qabrati i ka pastruar mbeturinat dhe pas tri ditëve është bërë prapë e njëjta gjendje, ne jemi në dijeni se disa qytetar i pastrojnë edhe vet edhe hapësirat publike, mirëpo ne duhet të jemi më aktiv dhe duhet pa tjetër të përmirësohet kjo gjendje dhe të shqiptohen edhe gjoba dhe do të jemi të pa mëshirshëm në këtë drejtim dhe nuk do të kemi tolerancë. Unë jam kundër subvencionimit të ndërmarrjeve shërbyese sepse qytetarët i paguajnë taksat ndaj komunës dhe paguhen ndërmarrjet shërbyese dhe ato mjete prapë ti paguajmë për ata qytetar që nuk paguajnë. Për çështjen e gjelbërimit kati dy muaj jemi konsultuar se a mundemi të bëjmë një kontratë me ndërmarrjen publike dhe kanë kaluar dy vite qysh komuna nuk ka pasur kontratë për gjelbërim dhe tani jemi shumë afër që të kemi një kontratë me Qabratn për gjelbërim. Në të gjitha takimet unë kam bërë thirrje dhe lutje që të kemi kujdes me trajtimin e mbeturinave. Nuk mundet me mbijetu qabrati nëse

20% nuk paguajnë sepse këtë përqindje e kanë fitim dhe ne kemi kërkuar që të inkasoj mjetet edhe përmes përmbaruesve dhe do të provojmë edhe me publikimin e emrave të atyre që nuk paguajnë .

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Informate mbi ndriçimin publik

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Informate mbi ndriçimin publik edhe pse kemi probleme në këtë sektor sidomos tek borxhet e trashëguara mirëpo kjo pikë është e paraparë në Planin e Punës së Kuvendit dhe e ftoj Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Shkumbim Kastrati që të merr fjalën .

z. Shkumbim Kastrati: Para jush e kemi prezantuar Raportin për Ndriçimin publik për këtë vite dhe komuna është në fazën e shpalljes së fituesit të tenderit për ndriçimin publik, në këtë vite do të kemi probleme për ndriçimin publik sepse i kemi në dispozicion vetë 23 .000€ për operatorin e ri ndërsa janë të planifikuara 150.000€ ndërsa borxhet janë për afërsisht kaq , dhe në fazën e dytë do të kemi tenderin për shtrirjen e rrjetit të ri . Problem kemi që në rastin e ndërrimit të shtyllave nga KEDS po na shkatërrohet komplet rrjeti i ndriçimit publik ku shtyllat janë aset i KEDS-it . Kompania ekzistuese është duke i kryer shërbimet deri sa të lidhet kontrata e re sepse e kemi të lidhur në kontratë aneks , kemi qenë korrekt mos të lëshojmë urdhëresa për punë në mënyrë që të ruajmë mjetet .

Kryesuesi: E Hapi diskutimin

znj. Saranda Hoda: Unë dua të shpreh shqetësimin e banorëve të rrugës Mbretëresha Teutë që është komplet e pa ndriçuar dhe kërkoj që të merren masa .

znj. Mimoza Shala: Disa herë kamë shpreh shqetësimin për ndriçimin publik mirëpo kamë marrë përgjigjeje se komuna ka shumë borxhe nga viti i kaluar dhe pajtohem me drejtorin që kërkon që të rritet buxheti për ndriçim andaj kamë kërkuar edhe në dy mbledhjet e kaluara që në rrugën Gjergj Fishta të rregullohet ndriçimi sepse nuk kërkon investim vetëm të ndërrohen poqët, si dhe rruga Ferid Domi është komplet në errësirë dhe është shumë e nevojshme të ndriçohet gjithashtu edhe rruga Shefki Shasivari .

z. Jeton Vorfi: Kamë një pyetje për drejtorin i cili tha se jemi në përfundim të nënshkrimit të kontratës për ndriçim publik a është e përfshirë edhe rruga Ymer Pula nga semaforët e deri tek ura që shkon për Shkugëz kjo kërkesë ka qenë edhe në mandatin e kaluar.

z. Muharrem Musa: Për ndriçimin Publik unë mendoj se kompania duhet të shkoj dhe të largoj ndriçimin publik nga shtyllat e KEDS-it kur të ndërrohen shtylla në mënyrë që mos të dëmtohet rrjeti i ndriçimit publik ndërsa sa i përket buxhetit kërkoj që të gjendet një zgjidhje dhe të sigurohen mjete sepse kërkesat janë shumë të mëdha për ndriçim publik .

znj. Albina Sadrija : U tha edhe nga parafolësit se investimi i KEDS-it në ndërrimin e shtyllave të rrjetit elektrik po shkakton dëmtimin e ndriçimit publik dhe po i shkakton dëme buxhetit të komunës andaj është e nevojshme arritja e një marrëveshje me KEDS-in për ofrimin e këtyre shërbimeve , po ashtu kërkoj që të bëhet ndriçimi i rrugëve në fshatin Nivokaz, Morin, Stubëll, Brovin, Bërbaj ku ka lagje që nuk kanë fare ndriçim dhe në disa lagje duhet të riparohet rrjeti.

z. Zef Komani: Sa i përket informatës paraprake për pastrimin e borës kërkoj që të keni në konsideratë se në Evropë pastrimi i trotuareve bëhet nga pronarët e shtëpive dhe lokaleve që i kanë aty secili para derës së vet , për ndriçimin publik , gjelbërimin e disa probleme të tjera andaj kërkoj nga Kryetari se si është e mundur që kanë kaluar 5 muaj dhe ende problemet e qytetarëve nuk kanë filluar të zgjidhen ende nuk kanë filluar të mbyllen gropat në rrugë dhe mendoj se problemi qëndron tek zyra e prokurimit dhe sipas informatave mbi

70% e tenderëve janë në OSHP dhe me gjithë këtë vullnet për punë është mirë që të shikohen procedurat se a janë duke shkuar në rregull . Duhet të shikohet se a është duke u bërë rishikimi i nevojave sepse kemi rasate që 7 vite kemi qytetarët që i kanë blerë vet llambat dhe ende nuk janë montuar nga Komuna .

z. Bekim Jupa: Ne i kemi bisedua edhe ne KPF raportin e mbeturinave si dhe raportin e ndriçimit publik unë vetëm dola që te përshëndes drejtorin e shërbimeve publike i cili është duke e bërë një punë të shkëlqyeshme që është shembull edhe për drejtoritë e tjera se si duhet punohet dhe si duhet te raportohet.

z. Sadik Hoti: Unë desha te bëj një pyetje lidhje me ndriçimin publik, censorët dhe poqët a ndërrohen vetëm përkohësisht për një muaj apo 2 muaj apo ndërrohen për një afat me te gjatë, kështu që dua te cekim se ne Rogovë nuk ka drita dhe dua te bëj një kërkesë drejtorit apo punë kryesit për rrugët tek xhamia dhe tek minoritete dhe tek shkolla dy shkollat, si dhe shtyllat në një pjesë të fshatit nuk janë ndërruar .

z. Fazli Hoxha: Ndriçimi duhet të shtrihet në tërë territorin e komunës dhe kemi fshatra që nuk janë të ndriçuar siç është fshati Koshare dhe Zylfaj dhe disa fshatra tjerë ku ndriçimi nuk është funksional, drejtori i cili ka qenë edhe në mandatin e kaluar është shumë i kujdesshëm në gjetjen e arsyeve si për ndriçimin publik dhe për menaxhimin e mbeturinave sepse kjo gjendje nuk është e mirë, kemi raste ku mbeturinat nuk pastrohen fare me nga 3 javë, edhe pse qytetarët i kryejnë obligimet ndaj kompanisë andaj duhet të ndryshohet qasja edhe e kompanisë edhe e drejtorisë duhet të veprohet në mënyrë konkrete dhe të jemi në shërbim të qytetarëve .

z. Bekim Jupa: Zotëri Hoxha unë nuk jam zëdhënës i Drejtorit z. Shkumbin Kastrati i cili ka qenë edhe në mandatin e kaluar drejtor dhe ka marrë shpërblime dhe nga Organizatat e huaja prestigjioze .

z. Fazli Hoxha: Gjatë një muaj fushatë ankesat më të mëdha kanë qenë për punën e drejtorisë për Shërbime Publike dhe po më vjen mirë kur po dëgjoj për mirënjohjet nga organizatat e huaja, por qytetarët kanë mendim ndryshe dhe unë propozoj që pas një kohe të bëhet vlerësimi i punës së drejtorëve dhe nëse ka rezultate të vazhdohet e nëse jo të bëni ndryshime sepse PDK ka kuadro të shumta dhe mundeni të bëni zgjidhje .

z. Agon Batusha: Sa i përket luftës për merita dhe mirënjohje unë mendoj se me punë mundeni të merrni mirënjohje të qytetarët dhe të keni votën dhe besimin e tyre . Për problemin e ndriçimit publik me KEDS-in unë e kam cekur edhe në mbledhjen e KPF-së se për me i ndërruar shtyllat e rrjetit Elektrik , KEDS-i duhet të merr leje në Drejtorin e Urbanizmit andaj duhet të lidhet edhe një marrëveshje që të kenë kujdes për mos dëmtimi e rrjetit të ndriçimit .Ish qeverisja disa herë ka potencuar se ndriçimi publik është bërë në të gjitha fshatrat dhe tani po shihet se në disa fshatra as shkollat nuk kanë ndriçim .

z. Shkumbin Kastrati: Shqetësimet e juaja janë me vend dhe është e vërtetë se ende ka nevojë për punë dhe ne nuk jemi të përkryer por deshta me e cek se KEDS-i nuk merr leje prej DUMM-së për me i vendos ndriçimin publik , por problemi është teknik sepse ndriçimi është i lidhur në rrejt të shpërndarës të KEDS-it në rrjetin e vjetër që do të thotë se edhe nëse vendosen llambat është i dalur nga sistemi sepse duhet të dërgohet kablo e veçantë sepse KEDS vendos tani kabëllen shpërndarëse të izoluar ,. Për çështjen e gropave u sqarua nga Kryetari është çështje e procedurave. për kategorizimin i kem i dy projekte projektin e mirëmbajtjes së rrjetit dhe projektin e shtrirjes së rrjetit të ri komplet , si dhe i mora edhe shqetësimet e juaja edhe për rrugën tek stadioni i qytetit që është rrugë e re dhe duhet të ketë rrjetë të ri komplet

Kryetari: Për çështjen e Mirëmbajtjes së rrugëve dhe renovimin e tyre nuk kemi se si të veprojmë pa u përfunduar procedurat e tenderimit dhe ne jemi shumë të interesuar që mos të vonohen punët mirëpo operatorët ekonomik po ankohen në OSHP dhe kjo po shkakton vonesa në procedura .

Kryesuesi: Tani po shkojmë në pauzën e kërkuar dhe kërkojmë që shefat e grupeve të takohemi në zyrën time lidhur me kërkesën për mbështetjen financiare të KH Shqiponja. .
Pas Pauzës vazhdojmë me mbledhje .

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës : Informata financiare Janar Mars 2018

Kryesuesi : Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Informatën Financiare për Periudhën Janar Mars 2018 e ftoj Drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe financa **z. Durim Halilaj** që të merr fjalën .

z. Durim Halilaj: Drejtoria për buxhet dhe financa e ka përgatitur Informatën e parë financiare për periudhën Janar Mars 2018, e cila është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Statutin e Komunës kjo informatë ka për qëllim informimin objektiv lidhur me ecurit dhe treguesit relevant të përmbushjes së planit të grumbullimit të të hyrave në këtë periudhë kohore, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programit, dinamikës e shpenzimeve të planifikuara në buxhet rrjedhën e parasë si dhe tregues të tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme në këtë periudhë kohore. Buxheti i aprovuar nga Kuvendi i Komunës është 23.266, 602,00€ për këtë periudhë kohore pra Janar Mars ka pësuar ndryshime nga donacionet dhe participimet në vlerë prej 1.154,895,00€ pra buxheti periodik është 23.381.997 €, gjatë kësaj periudhe janë alokuar mjete 6.467,751 ndërsa janë shpenzuar 4,732,3343 apo 73% po ashtu janë paguar borxhe të ish qeverisjes në vlerë prej një milion euro. Periudha janar Mars 2018 karakterizon një total të të hyrave me donacione 816,865,00€ apo 6.9% më shumë se planifikimi ndërsa krahasuar me vitin 2017, ka rritje 114,000.00€.

Kryesuesi: E hap diskutimin për këtë pikë:

z. Jeton Vorfi: Unë kamë dy pyetje për drejtorin tek rritja e shpenzimeve për komunalin në raport janë prezantuar janë 32.27% më shumë se vitin 2017 pra ka rritje prej 41 ,000€ pse ka ndodhur kjo .
Tek subvencionet kemi një rritje enorme prej 405% dhe kërkojmë sqarime sepse po figuron për shpenzime të varrimit .

z. Bekim Ermeni: Në takimin e KPF-së kemi diskutuar dhe kemi kërkuar disa plotësime që nuk janë marrë për bazë dhe nuk janë futur në këtë raport, të cilat po i ngris sot këtu dhe kërkojmë sqarime nga drejtori, angazhimi i punëtorëve shtesë që kemi një numër të caktuar të angazhuar me kontrata mbi vepër dhe ato kontrata mbi vepër thonë se ata punëtorë kanë një punë dhe një shërbim që e kryejnë, por ne nuk e dimë se sa persona janë, andaj kërkoj një informatë sa persona janë në kontratë mbi veprë sa i kushtojnë komunës dhe nëse është e mundur cilat punë i kryejnë ata .

Këtu kemi dy shifra të çuditëshme e para tek rregullimi i tokave ndërtimore ku kemi tejkalim 250% tek shndërrim i tokave Bujqësore në Jo Bujqësore 2400% këto vijnë si rezultat i kërkesave të qytetarëve mirëpo tejkalimi kaq i madhe në një periudhë dimri na bije në situata që të kërkojmë sqarime sepse është një periudhë e vështirë dhe e jo ndërtimeve andaj kërkojmë sqarime për këtë temë .

z. Durim Halilaj: Lidhur me pyetjen e z. Jeton Vorfi se janë rritur shpenzimet në Komunali ju keni të bashkangjitur edhe një shkresë ku është cekur se këto mjete janë bërë Pagesa e borxheve të vitit 2017 dhe e njëjta është edhe tek mallra dhe shërbime , ndërsa për subvencione ku përfitues individual 11.998 € kanë marrë subvencione konkretisht mbulimi i shpenzimeve të varrimit .

Lidhur me pyetjen e z. Ermeni planifikim në drejtorin e Bujqësisë ka qenë shumë i dobët ku këtë sektorë e ka udhëhequr z. Ermeni dhe në 3 mujorëshin e vitit 2017 është realizuar 17 419 ndërsa në këtë vit nuk është arritur ende ajo shumë por ka rënje dhe këto realizime kanë ardhur nga kërkesat e qytetarëve pra është mirë që edhe z. Ermeni të na sqaroj se pse në atë kohe është lejuar rritje dhe tani nuk po lejohen .

Kryetari : Kuvendi e ka për obligim që të mbikëqyr financat dhe unë e kamë për obligim që të mbaj këtë tempo sepse nëse e shihni faqen 5 në grafi konin e të hyrave vetanake për vite dhe këtu shihet rritje në tre mujorin e parë të vitit 2018 ku është 0.3% në dit pune ku këtu nuk futen donacionet edhe pse hyjnë në të hyrat vetanake , si dhe tek pagesa e borxheve janë paguar 1 milion euro nga 4.7 milion euro . Tek çështja e kontratave jeni në kuadër të planifikimeve dhe disa i kemi trashëguar, sa i përket të hyrave nga kërkesat për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore ju e dini se ekzistojnë procedura .

z. Bekim Ermeni: Unë po bëjë pyetje dhe po pres përgjigjeje e jo të bëjmë pyetje në pyetje sepse i keni pas kohë të mjaftueshme në dispozicion që të na njoftoni se i kemi kaq kontrata mbi vepër dhe kaq kushtojnë, ndërsa sa i përket shndërrimit të tokës është e drejtë e qytetarëve që të bëjnë kërkesa ajo dihet dhe unë jam shumë i qartë në pyetje e jo të bëjmë folklorizma këtu por të përgjigjeni në pyetjet e parashtruara

Kryetari: Drejtori i financave ka plotësisht të drejtë me të bërë pyetje ty z. Ermeni sepse këtë planifikim që ne jemi duke e tejkaluar e ke bërë ti dhe krahasimi me vitin paraprak bëhet me ty, andaj si mos me të bërë pyetje.

z. Zef Komani : Unë kërkoj që për mbledhjen e radhës të kemi një raport se për 4 vitet e fundit sa punëtor me kontrata mbi vepre i ka pasur komuna dhe kjo na i sqaron qartë këtë situatë, si dhe sa ka qenë inkasimi në vitin 2017 dhe në vitin 2018, sa i përket asaj se u tha nga z. Ermeni është e vërtetë se në periudhën e dimrit nuk ndërtohet po është e vërtetë se fillimisht kompletohen dokumentacionet andaj mos të bëhet politik këtu .

z. Jsuf Osmani : E përgëzojmë drejtorinë për Buxhet dhe financa që janë rritur të hyrat vetanake në Komunën e Gjakovës .

Kryetari: Sa i përket kontratave mbi vepër i kemi 22 persona dhe janë 30 kontrata që ju kanë përsëritur këtyre personave në mënyrë të kundërligjshme sepse ligji thotë se një person me kontratë mbi vepër mundet të punoj veç 6 muaj dhe këtyre ju ka përsëritur për 3 vite radhazi në kundërshtim me ligjin nga ish qeverisja .

z. Durim Halilaj: Unë prapë po e pyes z. Ermenin se si është planifikuar 600€ në vitin 2018 ku në vitin 2017 në tre mujorin e parë janë realizuar mbi 17.000.00€ atëherë si e ke planifikuar për vitin 2018 vetë, 600€ dhe kjo është arsyeja e kësaj rritje, pra këtu kemi të bëjmë me një keq planifikim nga ana e juaj z. Ermeni .

z. Agon Batusha: Pyetja e kolegut ishte konkrete se sa tani janë punësuar sepse në të kaluarën kanë qenë në vërejtjen e auditorit 22 të punësuar por tani sa janë. Në të kaluarën ne si VV vazhdimisht kemi kritikuar se është kaq bëhet keq planifikim dhe nuk është duke u treguar vullnet për rritjen e të hyrave, ne e kemi përshëndetur iniciativën për largimin e plakave reklamuese sepse kjo i rrit të hyrat e komunës dhe është në interes edhe të qytetarëve .

Kryetari: Sa i përket çështjeve të pronave komunale ne e kemi marrë mandatin në një situatë ku inkasomi është zero dhe në mbledhjen e fundit të bordit të drejtoreshave janë themeluar grupet punuese që do të fillojnë punën dhe shumë shpejtë do të hyjmë në sistem dhe do të ndodh rritja e të hyrave vetanake, sa i përket ndërtimeve unë kamë kërkuar nga drejtori i urbanizmit që të dal në teren dhe të shikoj planet rregulluese që të joshen njerëzit të ndërtojnë sepse janë disa arsye, në vitin e ardhshëm do të ndërtohet kolektori i impiantit

të ujërave të zeza dhe rruga Nën Tëreza hapet dhe unë kamë kërkuar nga disa pronarë të tokave që munden të ndërtojnë që të bëjnë ato ndërtime në këtë vit sepse në vitin e ardhshëm do të kenë vështirësi .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime tjera e shpalli të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës .

7. Pika e shtatë e rendit të Ditës: Shqyrtimi i kërkesës së KH Shqiponja për mbështetje financiare .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën për mbështetje financiare në vlerë prej 24.500.00€ për Klubin e Hendbollit K. H “SHQIPONJA” nga Gjakova e cila është hy si pik e rregull e rendi të ditës në këtë mbledhje që unë mendoj se nuk duhet të kemi këso praktika sepse ka shumë klube tjera që munden të na vërshojnë me kërkesa .

E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

z. Bekim Jupa : Këtë kërkesë e sqarova edhe në fillim të mbledhjes që ka të bëjë me kërkesën e KH Shqiponja për mbështetje financiare, këtë kërkesë zyra e Kryesuesi e ka të dorëzuar me dt. 29.03.2018 që i bije më shumë se 30 dit andaj sot e kemi prezantuar para jush që të miratohet kjo kërkesë sepse ky klub e përfaqëson Kosovën në arenën ndërkombëtare dhe është Kampion në Kosovë. Kërkoj nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që të përkrahet kjo kërkesë dhe të mbështesim këtë Klub në mënyrë unanime .

Kryetari: Sa i pokerët kësaj pike kemi një Udhëzim Administrativ që nuk na lejon të realizojmë këtë kërkesë, dhe kjo ndodhë sepse Kuvendi e miraton Buxhetin , dhe është vullneti imë me i ndihmuar këtë Klub po ky Klub ka aplikuar në DKRS për subvencione dhe janë edhe 3 dit për kohen e kësaj thirrje publike andaj ju mundeni të kaloni këtu sot mirëpo është shumë diskutabile baza ligjore e këtij vendimi . Unë propozoj që ky klub ti merre subvencionet e DKRS-së dhe pastaj shikojmë me tutje . Unë kam një takim me Shefin e OSBE-së dhe më duhet të lë këtë takim unë do të respektoj secilin vendim tuajin por do ta procedoj sipas ligjit.

Znj. Saranda Hyseni: DKRS e ka trashëguar nga ish qeverisja një buxhet prej 120.000€ nga këto 100.000€ për klube sportivë dhe 20.000€ për sektorin e rinisë . sa i përket subvencioneve duke u bazuar në rregulloren e MEF-it e kemi bërë thirrjen Publike dhe i kemi cekur kriteret dhe i kemi kontaktuar edhe përfaqësuesin e KH Shqiponja, dhe një shumë të vogël e kemi për subvencione dhe kërkesat e klubeve janë shumë më të mëdha andaj ne do të veprojmë sipas mundësive tona.

z. Bekim Jupa: Kërkesa është në harmoni me ligjin dhe udhëzimet administrative nëse këtu është shkelur ligji është bërë nga kuvendi që nuk i ka kthye përgjegjëse në kërkesën e parashtruar, ne duhet ta përkrahim këtë klub duke pasur parasysh se merr pjesë në gara ndërkombëtare dhe i duhet pa tjetër ndihma jonë . Unë i falënderoj opozitën në këtë rast që e kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë .

znj. Saranda Hyseni : Të gjitha klubet mjetet i marrin në disa faza dhe jo në total gjë që do ti merre edhe KH . Shqiponja , sa i përket kërkesës në mandatin e kaluar unë jam shumë e kënaqur që e kemi përkrahur atë kërkesë dhe ato mjete që i janë ndarë atëherë nuk i ka marrë aj klub edhe sot e kësaj dite.

z. Muharrem Musa: Unë po i drejtohem z. Bekim që foli për AAK-në dhe jeni shumë gabim sepse ne e përkrahim këtë e ka përkrahur edhe Kryetari dhe kemi marr qëndrim me i ndarë mjetet por në atë që u thirret ne i përkrahim të gjitha klubet por duhet të kemi përsyshë mundësit buxhetore dhe të kemi kujdes edhe me klubet tjera dhe në rishikim të buxhetit të shohim se çka kemi mundësi . Ne si grup e përkrahim KH Shqiponja e ka përkrahur edhe Kryetari por me rishikim të buxhetit të shikojmë se çka mundemi me veprua.

Znj. Mimoza Shala: Secili nga ne e kemi të drejtën tonë të votoj por ose kundër por më vije keq edhe nga Drejtoria e cila ka buxhetin e limituar por tani kjo është bërë edhe shprehi sepse edhe klubi vllaznimi e ka përfituar një shumë të madhe të mjeteve, mirëpo KH Shqiponja ka arritur suksese dhe na përfaqëson në arenën ndërkombëtare, si dhe në këtë klub po luajnë vajzat dhe mendoj se ne duhet ti përkrahim por të diskutohet shuma e mjeteve meqenëse drejtoria ka probleme buxhetore.

znj. Dafina Sylja: Unë jam në përkrahje të kësaj kërkesë sepse Klubi përbehet nga Femrat dhe apeloj se sa më shumë të kemi klube të tilla të suksesshme, dhe këtë klub e definon suksese ku janë në 16 të garave më të rëndësishme të Evropës. Unë jam që të mbështetet kjo kërkesë dhe është çështje e ekzekutivit se si do të sigurohen mjetet për mbështetje të këtij klubi dhe nëse nuk zbatohet atëherë është shkelje ligjore .

z. Jusuf Osmani : Unë dua ti drejtohem z. Bekim Jupa i cili po aktron shumë mirë dhe po bënë politik dhe nëse e doni aq shumë KH Shqiponja pse nuk po e shfrytëzon pozicioni tuaj dhe të loboni në Ministrinë e Kulturës për mbështetje të këtij Klubi i cili është krenaria e Gjakovës dhe merr pjesë suksesshëm në arenën ndërkombëtare, dhe unë do ta mbështes këtë kërkesë por duhet të gjejmë zgjidhje e jo të bëjmë politik me këto gjëra .

z. Bekim Jupa: Nëse ju z. Osmani e keni marrë si teatër Kuvendin atëherë nuk ka qenë dashur të vini këtu , sepse është një kërkesë e drejtë dhe kërkoj që ju AAK të deklaroheni a jeni pro apo kundër ju kërkoj të merrni shembull nga opozita se kush është në të mirën e komunitetit .

z. Zef Komani: Tek unë nuk ka intervenuar as kush dhe ky Klub nuk është i as një subjekti politik, ne duhet ta gjemë një zgjedhje asamblistit kanë të drejtë sepse është i vetmi klub merr pjesë në gara ndërkombëtare dhe me mjaft sukses , por e kuptoj edhe drejtoreshën që u deklarua se nuk kemi mjete të mjaftueshme, andaj unë mendoj se duhet ta përkrahim në parim dhe mos ta caktojmë shumën dhe ti qëndrojmë mendimit dhe të kemi në kujdes që në rishikim të Buxhetit ti ndahen mjetet DKRS- par propozoj që të përkrahet si kërkesë e arsyeshme .

z. Bekim Ermeni: Unë mendoj se nëse ndonjë klub ja vlen me u përkrahë është KH Shqiponja sepse i ka rezultatet e përfaqëson Kosovën në arenën ndërkombëtare dhe është klub kampion dhe këtu nuk po diskutohet çështja e klubit por çështja e kompetencave dhe çfarë vendimi me mare , ne të gjithë përfaqësuesit e Kuvendit u pajtuam që të mbështete dhe meqenëse se jem i në proces të aplikimit për subvencione të DKRS-së ta votojmë këtë vendim dhe komisioni i drejtorisë për vlerësimin e aplikim të ja hapim rrugën drejtorisë me miratimin e këtij vendimi për tu vlerësuar projekti i këtij klubi dhe nëse është mbi 15,000€ mos të pret vendimin e kuvendit por të veprojmë sipas kërkesës .

z. Muharrem Musa: Ne jemi në mbështetje të klubit por tani jemi për shumën që i është ndarë nga DKRS-ja dhe në të ardhëm të shikojmë se çfarë mundemi të bëjmë .

znj. Diana Qarkagjia: Ne kemi pranuar një kërkesë nga klubi Shqiponja për të cilën jemi në parim dhe do të përkrahim çdo gjë që është në harmoni me procedurat ligjore, Kuvendi duhet të gjej zgjidhje dhe mundësia është që nga Kabineti i Kryetarit të ndahet një pjesë e subvencioneve dhe ky klub të shkoj drejtë sukseseve të mëtutjeshme.

Kryesuesi: Besoj se jemi në rrugë të mirë të gjetjes ë një zgjidhje dhe vazhdojmë me diskutimet

Znj. Florentina Gjergjaj: U tha edhe nga shefi i grupit se edhe ne si AAK jemi në parim që të mbështesim këtë kërkesë dhe të gjitha kërkesat që kanë të drejtë ligjore por që janë në përputhshmëri me buxhetin . Kërkoj nga z. Bekim Jupa që mos të na referohet me marrë shembull nga opozita sepse në mandatin e kaluar

një pjesë e kësaj opozite ka qenë në pushtet dhe kanë marrë vendim për përkrahjen e këtij Klubi por një pjesë të mjeteve edhe sot e kësaj dite nuk ja kanë derdhur në llogarit e këtij klubi

z. Edmond Dushi: Unë e kom potencuar vazhdimisht se në parim jemi për me i përkrah klubet sportive por në këtë rast jemi duke folë konkretisht se a duhet të ndahet kjo shum e mejteve për këtë klub apo jo, u propozua që shuma mos të caktohet, ndërsa në anën tjetër ky klub është në procedura që të fitoj një shumë të mjeteve nga Subvencionet e DKRS-së , atëherë unë mendoj se nuk mundemi të marrim vendim pa e caktuar shumën dhe ai vendim mundet të kthehet edhe nga Ministra kështu që unë mendoj se 'këtë çështje të kryej DKRS-ja me subvencione dhe pastaj të shohim me rishikimi të buxhetit .

z. Agon Batusha: Unë pajtohem me z. Dushi se ne nuk mundemi të marrim vendim pa e caktuar shumën dhe një gabim është bërë edhe nga qeverisja që u nda një shumë e madhe për Vllazninin .

z. Bekim Jupa : Ne duhet ta votojmë këtë dokument kërkesën e Klubit dhe ju ftoj që të votohet kjo kërkesë ashtë siç është dorëzuar nga Klubi e jo në parim apo si u propozua këtu.

Kryesuesi: Unë propozoj që të gjejmë një zgjidhje të përbashkëte një konsensus ta përkrahim në parim këtë kërkesë e jo të ndahemi në qëndrime .

z. Bekim Jupa : Kërkoj nga ju Kryesues që ta hedhim në votim këtë kërkesë të Klubit dhe të miratohet ose jo, andaj kërkoj që ta hidhni në votim ski zgjidhje tjetër .

z. Bekim Ermeni: Ne po dëshirojmë ti gjejmë zgjidhje ekzekutivit për me e mbështet këtë kërkesë, që Komisioni i DKRS-së të bëjmë vlerësimin e projektit që është dorëzuar nga ky klub dhe nëse nuk është dorëzuar të dorëzohet deri të martën ku aj komision e vlerëson se cila shumë do të ndahet por nuk mundemi sepse kuvendi nuk e ka miratuar , andaj ne sot po e verojmë që të mbështetet projekti i këtij klubi i cili do të mbështete nga Komisioni dhe nëse ka shumën më të madhe mbi 15.000€ të bazohet në këtë vendim të kuvendit .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime E qes në votim miratimin e kërkesës së KH Shqiponja për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 24.500.00€, **Kush është: Për, Kundër, Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu 25 pro, 3 kundër dhe 2 abstenim ,** pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M

- 1.** Aprovohet kërkesa për mbështetje financiare në vlerë prej 24.500.00€ për Klubin e Hendbollit K. H "SHQIPONJA" nga Gjakova.
- 2.** Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të shpenzohen nga Klubi i Hendbollit K.H "SHQIPONJA" me qëllim që ky klub ti mbuloji obligimet e parapara në Planin Financiar Janar-Dhjetor 2018 .
- 3.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

8. Pika e tetë e rendit të ditës : Të Ndryshme

Kryesuesi : Për këtë pikë ët rendit të ditës kemi të ndryshëm a ka dikush ndonjë diskutim sa i përket kësaj Pike .

Znj. Mimoza Shala: Ne e kemi të drejtën e lirë të votës dhe askush nuk ka mundësi dhe as nuk ka ndikim tek ne andaj nuk ka të drejtë askush të thotë se ratë nën ndikim. Të gjithë e dimë se 7 Maj është datë historike është Epopeja e Çabratit dhe kërkojmë nga drejtori i DKA-së që me këtë datë në orët e para në shkollat fillore dhe të mesme të trajtohet kjo datë si ngjarje e rëndësishme .

z. Jeton Vorfi : Ne të gjithë jemi në dijeni se edhe në mandatin e kaluar por edhe ku ju keni qen drejtori z. Kryesues keni pasur këso kërkesa dhe keni kërkuar mjete shtesë andaj meqë kemi të bëjmë me këtë klub mendoj se duhet të kërkojmë donacione dhe të mbulohet kjo shumë . Pyetja është për drejtorin e shërbimeve publike lidhur me rrugën Petro Niluarasi ku banorët e kësaj lagja kanë disa ankesa pikërisht tek vendi ku bëhet shikimi teknik i automjeteve tek kycja aty ka parking ilegal dhe e rrezikon lëvizjen e lirë dhe kërkojmë intervenim andaj propozoj të vendosen shenja të ndalimit të parkingut.

z. Agon Batusha: Kam disa kërkesa se mbledhjet e bordit janë duke u mbajtur të mbyllura si për mediat ashtu edhe për publikun dhe OJQ-të kjo praktik duhet të heket mbledhjet e Bordit duhet të jenë të hapura të jen edhe mediat prezent . Bashkësitë Lokale nuk e kanë informacionin se kush është personi kontaktues me bashkësitë lokale në komunë. Barnatoret kujdestare para disa viteve kemi pasur kujdestari në barnatore ndërsa sot nuk ka askund në Gjakovë andaj kërkojmë nga Drejtoria për shëndetësi që të kenë kujdes dhe të jetë një barnatore kujdestare. Kërkesë tjetër është nga qytetarët për ndërtimin e trotuareve që shkojnë në Shkugëz .

znj. Saranda Hyseni : Sa i përket datës 7 Maj dita e Epopesë së Çabrtait ne si DKR-së jemi të hapur dhe do ta mbështesim me të gjitha asetet tona që i kemi në dispozicion . Sa i përket asaj që u tha për Klubin ato janë OJQ dhe duhet të angazhohen vet ndërsa me dt. 17 Maj do të organizohet në këtë sallë takim me Kryetarin dhe përfaqësues të organizatave të ndryshëm me Klubet e Sportit dhe i ftoj që të marrin pjesë të gjithë .

z, Shkumbin Kastrati : Sa i përket rrugës Petro Niluarasi së shpejti do të përfundoj ai projekt dhe do të zgjidhet ai problem, trotuari për shkukëz është brengosës me të vërtet dhe do të shikojmë me kontratën vjetore se si do të veprojmë ndërsa do të kemi investime në brendësi të Shkukëzes dhe do të shikojmë mundësit për këto kërkesa.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u pafshim në takimet e radhës.

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 12:20 .

Procesmbajtës

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit

z. Anton Shala